



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:207565
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05250983

Ac.nr.8703/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A Divizioni i Furnizimit, Distrikti Gjakovë, kundër të paditurit M.K nga fshati T., Komuna e Malishevës, lidhur me kompensimin e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë, C.nr.42/11, i datës 28.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditurit M.K nga fshati T., Komuna e Malishevës ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë –Dega në Malishevë, C.nr.42/11, i datës 28.09.2021, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje të serishme.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.42/11, i datës 28.09.2021, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në vijim:

“I.MIRATOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A Divizioni i Furnizimit, Distrikti Gjakovë.

II.DETYROHET i padituri M.K nga fshati T., Komuna e Malishevës, që paditëses në emër të borxhit për konsumim të energjisë elektrike t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,968.57 € të përlllogaritur për periudhën nga data 06.10.2009 deri me datën 04.10.2010, të gjitha këto me

kamatë ligjore prej 3.5 % nga dita e përpilimit të këtij Aktgjykimi datë 28.09.2021, e në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit të detyruar. III.DETYROHET i padituri që t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 50.00 euro.

IV.REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses për shkak të parashkrimit në shumën prej 6,170.10 euro e përlllogaritur gjerë me datë 27.09.2009.”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe me propozim që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet apo lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala paditëse.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 03.11.2010 fillimisht ka paraqitur propozim për ekzekutim ndaj të paditurit ashtu që pas paraqitjes së kundërshtimit nga ana e të paditurit, çështja ka vazhduar sipas rregullave të procedurës kontestimore, duke u konsideruar si padi. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, C.nr.42/11, i datës 28.09.2021e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses KEK duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktgjykimit theksohet se vlerëson se i padituri për shkak të mos pagesës borxhit për shërbimin – konsumimin e energjisë elektrike, ka hyrë në raport detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit, kurse i paditurit e ka cilësinë e debitorit. Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të të paditurit lidhur me parashkrimin e borxhit, gjeti se prapësimi i të paditurit është pjesërisht i bazuar, për faktin se borxhi i ngarkuar për të paditurin për periudhën kohore gjerë me datë 27.09.2009 që përfshinë shumën prej 6,170.10 euro është borxh i parashkruar, ngase paditësja propozimin për përmbarim e ka paraqitur më datë 03.11.2010, që rezulton se deri më këtë datë është parashkruar borxhi për këtë shumë, bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare e RSFJ. Nr. 40/53 dhe 57/54) ligj i cili ishte në fuqi në kohën e krijimit të marrëdhënies juridike në nenin 378 parashihet citoj lidhur me parashkrimin e kërkesave përcaktohet se “Parashkruhen për një vjet kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, Kërkesa e radiostacionit dhe kërkesa e radiotelevizionit për përdorimin e aparatit të radios dhe të aparatit televiziv, Kërkesat e postës, telegrafit e të telefonave për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afatet tremujore, apo më të shkurtëra, Kërkesat e parapagimit në botimin periodik,

duke llogaritur nga skadimi i kohës për të cilin është porositur botimi, Parashikimi rrjedh ngjithëse livrimet apo shërbimet janë zgjatur”, ndërsa si borxh valid të cilën detyrohet t’ a paguaj i padituri është shuma prej 1,968.57 euro e përlllogaritur për çdo muaj nga data e paraqitjes së propozimit për përmbardim, dhe se nga kjo datë konsiderohet se me paraqitjen e propozimit nga ana e paditëses i njëjti e ka ndalur parashkrimin e borxhit, lidhur me ndërprerjen e parashkrimit në dispozitat e LMD –së neni 387 përcaktohet se “Parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin, Pohimi i borxhit mund të blihet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit.”, dhe mbi këtë bazë, gjykata gjen se detyrimi i të paditurit rrjedhë në bazë të nenit 17 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet citoj “Pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, përgjegjës për përmbushjen e tij”, po ashtu në nenin 262 të të njëjtit ligj parashihet citoj “Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”.

Vendimi për shpenzime procedurale është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për taksën gjyqësore shumë prej 50 euro.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 lidhur me nenin 199 të LPK-së si dhe neni 160.4 dhe 160.5 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë e si rezultat i kësaj edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Duke vlerësuar pretendimet ankimore të palës së paditur Gjykata ankimore vlerëson se të njëjtat qëndrojnë ashtu që fillimisht kjo Gjykatë gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me nenin 160.4 dhe 160.5 të LPK-së, ku neni 160.4 përcakton se: “Arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”, ndërsa neni 160.5 përcakton se: “Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohej edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”.

Duke pasur parasysh dispozitat e sipërcituara, Gjykata e Apelit vëren se: arsyetimi i aktgjykimit përmban vetëm deklaratimet dhe kërkesat e palëve në procedurë, si dhe vetëm janë përshkruar provat të cilat gjykata i ka nxjerrë për vërtetimin e gjendjes faktike, mirëpo në arsyetim të aktgjykimit në asnjë pasus të tij, nuk vërehet se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se përse i ka marrë për bazë provat e nxjerra, se çfarë fakte ka vërtetuar dhe përse i ka vërtetuar ato fakte,

cilat fakte kanë qenë kontestuese për palët, cilat fakte kanë qenë vendimtare për vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit e që realisht gjykata detyrimisht duhet të bëjë vlerësimin dhe konstatimin e secilës provë veç e veç, vlerësim të cilin në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dështuar ta bëjë në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, pra arsyetimi është tërësisht përshkrim i veprimeve dhe pretendimeve të palëve por assesi vërtetues i fakteve mbi të cilat është mbështetë vendimi i tillë.

Po ashtu Gjykata e Apelit gjen se është e pa qartë për të cilën kërkohet borxhi. Pra, ekstrakti në bazë të të cilit kërkohet borxhi është lëshuar për periudhën nga data 27.09.2009 ku fillon me shumën prej 6,170.10 euro e deri me datën 21.05.2021, që e bën të paqartë se a kërkohet për tërë këtë periudhë borxhi apo vetëm për një periudhë të caktuar. Pastaj është e pa qartë se nga ka ardhur shuma prej 6,170.10 euro, pra nga është bartur pasi që tek përshkrimi në ekstrat figuron bilanc i bartur nga DPZ. Meqenëse aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë nuk do të lëshohet në pretendimet e tjera rreth vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale për arsye se aktgjykimi i marrë në këtë formë është i pa qëndrueshëm dhe si i tillë nuk mund të pranohet nga Gjykata ankimore.

Në riprocedurë Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë konform vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit ashtu që fillimisht të eliminojë shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetojë saktë periudhën për të cilën paditësi kërkon borxhin e pretenduar për shpenzimet e energjisë elektrike, të vërtetojë se nga ka ardhur shuma e kërkuar dhe çfarë nënkupton bilanci i bartur, më pastaj të vërtetohet në plotni gjendja faktike, duke identifikuar qartësisht objektin e çështjes, të zbatohet e drejta materiale në raport me kërkesat e palës dhe krejt në fund vendimi të jetë në përputhje me kërkesat nga neni 160 i LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8703/2021 me dt. 26.01.2024

Kryetare kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.